



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIC OF KOSOVO	
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS	
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA	
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO	
Zyra për Propozime dhe Parashtrës-Kancelaria za Predloge i Predstavka-Table Office	
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No:	08/4773/Do-2123
Nr. i faqeve No. pages:	30.11.2023
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA	

**Për:** Kryesinë e Kuvendit të Republikës së Kosovës  
Z. Glauk Konjufca, Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës

**Përmes:** Zyres për Propozime dhe Parashtrës  
Kuvendi i Republikës së Kosovës

**Nga:** Ariana Musliu - Shoshi, deputete e grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), në emër të deputetëve parashtrues të kërkesës

**Lënda:** Kërkesë për themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar

**Data:** 27 nëntor 2023

Në bazë të nenit 77, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 46 të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 4 të Ligjit Nr. 03/L-176 për Hetim Parlamentar, i paraqesim Kryesisë së Kuvendit propozimin për themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar, me objekt hetimi çështjen si në vijim:

- **Hetim parlamentar lidhur me nivelin e menaxhimit të marrëdhënies së punës të anëtarëve të Shërbimit të Jashtëm dhe zyrtarëve të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;**

### **A r s y e t i m**

Duke u bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Rregulloren e Kuvendit dhe Ligjin Nr. 03/L-176 për Hetim Parlamentar, i dërgojmë Kryesisë së Kuvendit, propozimin për themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar, për hetimin e procesit vendimmarrës (vendimeve, veprimeve dhe mosveprimeve) të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës në raport me zbatimin e procedurave ligjore lidhur me marrëdhënien e punës të anëtarëve të Shërbimit të Jashtëm dhe zyrtarëve të ministrisë dhe të gjitha aspektet e tjera, duke përfshirë procedurat e rekrutimit, emërimet e stafit, transferimet, gradimet, degradimet, angazhimet e përkohshme për punë dhe detyra specifike, etj, përgjatë mandatit të deritanishëm të kësaj qeverie, respektivisht

nga dita e themelimit të saj 22 mars 2021 e deri në ditën e themelimit të këtij Komisioni.

Gjithashtu, duke ju referuar edhe Raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për vitin 2022, në bazë të cilit janë identifikuar parregullësi të ndryshme të cilat hyjnë në përgjegjësinë e nivelit më të lartë menaxherial të kësaj ministrie, konsiderojmë se është më se i nevojshëm themelimi i këtij Komisioni Hetimor Parlamentar.

Derisa politika e jashtme, si sfera më e rëndësishme e mirëmbajtjes, zhvillimit dhe forcimit të subjektivitetit ndërkombëtar dhe e mbrojtjes së interesit shtetëror të Republikës së Kosovës, për rreth tri vite të punës së kësaj qeverie, nuk ka shënuar ndonjë sukses, është evidente se kjo është edhe pasojë e dështimit për të menaxhuar shërbimin e jashtëm, si bartësi kryesor administrativ i politikës së jashtme.

Niveli i tillë i qeverisjes dhe udhëheqjes me politikën e jashtme, është i dëmshëm, e për rrjedhojë, edhe i papranueshëm. Fatkeqësisht, qeveria nuk ka shënuar ndonjë sukses në aspektin e anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Organizata Ndërkombëtare, e aq më pak, të ketë shënuar ndonjë sukses në planin e lobimit dhe njohjes së Republikës së Kosovës, nga shtetet të cilat nuk e kanë njohur.

Gjendja në të cilën gjendet politika e jashtme, kërkon adresim të menjëhershëm, në mënyrë që të ndalohet trendi i degradimit të mëtejshëm të kësaj fushe shumë të rëndësishme të përgjegjësisë qeverisëse. Shto këtu, edhe faktin e de-funksionalizimit të shumicës së misioneve kryesore diplomatike dhe konsullore në shumë shtete, duke pamundësuar edhe ushtrimin efektiv të detyrave dhe misionit themelor që kanë këto nivele përfaqësimi të vendit, në planin ndërkombëtar.

Fatkeqësisht, kjo ministri ka shënuar përgjithësisht regres në përmbushjen e përgjegjësisë të saj ligjore, kjo përveç tjerash, edhe për faktin e emërimeve dhe shkarkimeve të paligjshme të anëtarëve të shërbimit të jashtëm dhe zyrtarëve kompetent të ministrisë.

Prandaj, fushëveprimi i punës hetimore të Komisionit të propozuar, është në pajtim të plotë me nenin 2 "Fusha e veprimit" të Ligjit për Hetim Parlamentar, dhe puna hetimore e tij, do të përfshijë dhe do të kufizohet në ndriçimin e fakteve, konstatimin dhe përshkrimin e rrjedhës së ngjarjeve me qëllim të qartësimit të asaj se çfarë ka ndodhur nga vendimet, veprimet dhe mosveprimet e titullarëve të MPJD-së në fushën e menaxhimit të stafit diplomatik dhe anëtarëve të shërbimit të jashtëm.

Ne, deputetët parashtrues të kësaj kërkesë, me qëllim të ushtrimit të mandatit tonë kushtetues parlamentar, theksojmë nevojën e madhe të zhvillimit të këtij hetimi, veçanërisht kur kihet parasysh fakti që kjo ministri ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë për menaxhimin e proceseve të politikës së jashtme të Republikës së Kosovës.

Edhe pse deri më tani, në disa raste Kuvendi i Republikës së Kosovës ka diskutuar për politikën e jashtme, asnjëherë nuk ka marrë përgjegjësinë për ngritjen dhe zhvillimin e një hetimi parlamentar që do qartësonte nivelin e përgjegjësisë ligjore të titullarëve të kësaj ministrie për gjendjen në të cilën e kanë sjellë këtë ministri.

Një komision i tillë Hetimor Parlamentar, përveç që do të përmbushte obligimin kushtetues parlamentar që kanë Deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës për mbikëqyrje, ndër të tjera, edhe të qeverisë, do të ndihmonte po ashtu në sqarimin e përgjegjësisë ligjore dhe menaxheriale të kësaj ministrie si dhe do të garantonte transparencë institucionale duke hedhur dritë mbi të vërtetat e pa njohura për qytetarët e Kosovës lidhur me disa nga pyetjet kyçe si në vijim:

- Mbi çfarë baze ligjore dhe çfarë kriteresh është bërë fuzionimi i Ministrisë së Diasporës me atë të Punëve të Jashtme?
- Mbi çfarë baze ligjore janë lidhur kontratat për angazhim të këshilltarëve nga jashtë?
- Mbi çfarë baze ligjore janë përjashtuar diplomatët e pranuar me konkurs në vitin 2011?
- Mbi çfarë baze ligjore janë transferuar diplomatët nga një mision në tjetrin?
- A janë përmbushur kriteret për transferimin e zyrtarëve publik në pozita udhëheqëse në MPJD?
- Si janë realizuar transferimet e zyrtarëve brenda MPJD-së?
- A janë respektuar afatet ligjore nga Komisioni i Gradave dhe Disiplinës?
- A janë zbatuar kriteret ligjore me rastin e nxjerrjes së vendimeve për ngritjen në gradë dhe në procesin e rotacionit?
- A janë dërguar zyrtarë pa përvojë në shërbime jashtë vendit?
- Mbi çfarë baze janë bërë emërimet politike?
- Në sa raste dhe a janë zbatuar procedurat ligjore për plotësimin e pozitave me Ushtrues Detyre?
- A janë respektuar kriteret për pranim në punë në këtë ministri?
- A ka pasur zbatim të standardeve të dyfishta me rastin e pagesës së pagave të zyrtarëve jashtë vendit?
- A ka pasur raste të punësimit të personave me kontratë mbi vepër dhe nëse po, mbi çfarë kushte dhe kriteret?
- A është zbatuar kriteri ligjor për pensionimin e zyrtarëve që kanë mbushur moshën 65 vjeç?
- A ka pasur shkelje të të drejtave nga marrëdhënia e punës të zyrtarëve të MPJD-së?

Këto dhe shumë pyetje të tjera, pa paragjykim, Komisioni Hetimor Parlamentar do t'i shtroj para vetës dhe do të duhej t'ju jap përgjigje përmes një raport përfundimtar, profesional, të bazuar në fakte dhe në prova, dhe do t'ia paraqes Kuvendit të njëjtin për miratim.

Për sa më sipër, si dhe me qëllim të përcaktimit të përgjegjësisë së zyrtarëve përgjegjës në lidhje me aspektet e mësipërme, Komisioni në punën e tij hetimore, do të pëfshijë

por nuk do të kufizohet në bashkëpunimin me cilindo person privat apo publik, institucion apo organizatë, të cilët sipas vlerësimit të tyre, do të ndihmojnë në sigurimin e të dhënave, të provave apo sqarimeve relevante që i përgjigjen qëllimit për të cilën Komisioni është themeluar dhe të arrijë në një përfundim të caktuar në pajtim me legjislacionin në fuqi.


Ne, deputetët parashtrues të kësaj kërkesë, propozojmë që Komisioni Hetimor parlamentar në përbërjen e tij të këtë njëmbëdhjetë (11) anëtarë, dhe në pajtim me ligjin në fuqi, mandati i këtij komisioni të jetë gjashtë (6) muaj, nga dita e themelimit të tij nga Kuvendi.

Për fund, ne deputetët parashtrues të kësaj kërkesë theksojmë se mirëpresim shqyrtimin në Kuvend të fushëveprimit të punës së këtij Komisioni si dhe jemi të gatshëm të shtojmë objektin e çështjeve që lidhen me procesin e menaxhimit të përgjithshëm të MPJD dhe natyrisht vetëm me pajtimin tonë si propozues, të finalizojmë listën e çështjeve me të cilat do të merret komisioni hetimor i propozuar.

Ju faleminderit!

Me respekt!

**Ariana Musliu – Shoshi**




**Deputete**


Lista e deputetëve nënshkrues të kërkesës për:

- **Hetim parlamentar lidhur me nivelin e menaxhimit të marrëdhënies së punës të anëtarëve të Shërbimit të Jashtëm dhe zyrtarëve të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës:**


1. ARDIAN PASTRATI  
(Emri dhe mbiemri)

  
(Nënshkrimi)


2. Feral Yhalla  
(Emri dhe mbiemri)

  
(Nënshkrimi)

3. BIERTA DEJLI  
(Emri dhe mbiemri)

  
(Nënshkrimi)


4. ELMI REÇICA  
(Emri dhe mbiemri)

  
(Nënshkrimi)


5. GANIHE MUSLIU  
(Emri dhe mbiemri)

  
(Nënshkrimi)


6. ABELARD TAHIRI  
(Emri dhe mbiemri)

  
(Nënshkrimi)

7. J. J. IZA HOXHA  
(Emri dhe mbiemri)

  
(Nënshkrimi)

8. ARIANA Musliu Shosti  
(Emri dhe mbiemri)

  
(Nënshkrimi)



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

---

**Za: Predsedništvo Skupštine Republike Kosovo**  
**Glauk Konjufca, predsednik Skupštine Republike Kosovo**

**Preko: Kancelarije za predloge i predstavke**  
**Skupština Republike Kosovo**

**Od: Ariana Musliu - Shoshi, poslanica PG PDK, u ime podnosioca zahteva**

**Predmet: Zahtev za formiranje Anketne parlamentarne komisije**

**Datum: 27. novembar 2023.**

---

Na osnovu člana 77. Ustava Republike Kosovo, člana 46. Poslovnika Skupštine i člana 4. Zakona br. 03/L-176 o parlamentarnoj istrazi, podnosimo Predsedništvu Skupštine predlog za osnivanje Anketne parlamentarne komisije u vezi razmatranja sledećeg pitanja:

**- Parlamentarna istraga o nivoa upravljanja radnim odnosom pripadnika Službe spoljnih poslova i službenika Ministarstva spoljnih poslova i dijaspore;**

### **O b r a z l o ž e n j e**

Na osnovu Ustava Republike Kosovo, Poslovnika Skupštine i Zakona br. 03/L-176 o parlamentarnoj istrazi, upućujemo Predsedništvu Skupštine predlog za formiranje parlamentarne istražne komisije za ispitivanje procesa donošenja odluka (odluke, radnje i nečinjenja) Ministarstva spoljnih poslova i dijaspore u vezi sa sprovođenjem zakonskih procedura koje se odnose na radni odnos pripadnika Službe spoljnih poslova i službenika ministarstva i sve druge aspekte, uključujući procedure zapošljavanja, imenovanja osoblja, premeštaja, unapređenja, degradiranja, privremenih angažovanja na određenim poslovima i dužnosti i sl., tokom aktuelnog mandata ove vlade, odnosno od dana osnivanja 22. marta 2021. godine do dana osnivanja ove komisije.

Takođe, pozivajući se na Izveštaj o reviziji godišnjih finansijskih izveštaja Ministarstva spoljnih poslova i dijaspore za 2022. godinu, na osnovu kojeg su utvrđene različite nepravilnosti koje spadaju u nadležnost najvišeg rukovodećeg nivoa ovog ministarstva, smatramo da je neophodno formiranje ove Anketne parlamentarne komisije.

Dok spoljna politika, kao najvažnija sfera održavanja, razvoja i jačanja međunarodnog subjektiviteta i zaštite državnog interesa Republike Kosovo, za oko tri godine rada ove vlade, nije zabeležila nikakav uspeh, evidentno je da je to i posledica ne upravljanja spoljnom službom, kao glavnim administrativnim nosiocem spoljne politike.

Takav nivo upravljanja i rukovođenja spoljnom politikom je štetan i stoga neprihvatljiv. Nažalost, Vlada nije postigla nikakav uspeh u pogledu članstva Republike Kosovo u međunarodnim organizacijama, a još manje je postigla uspeh u planu lobiranja i priznavanja Republike Kosovo, od strane država koje nisu prepoznao to.

Stanje u kome se nalazi spoljna politika zahteva hitno rešavanje kako bi se zaustavio trend dalje degradacije ove veoma važne oblasti državne odgovornosti. Dodajte ovde i činjenicu defunkcionalizacije većine glavnih diplomatsko-konzularnih predstavništava u mnogim zemljama, što onemogućava efektivno obavljanje osnovnih dužnosti i misije koje ovi nivoi predstavljanja zemalja imaju na međunarodnom nivou.

Nažalost, ovo ministarstvo je generalno nazadovalo u ispunjavanju svojih zakonskih obaveza, između ostalog i zbog nezakonitog imenovanja i razrešenja pripadnika spoljne službe i nadležnih službenika ministarstva.

Dakle, delokrug istražnog rada predložene Komisije je u potpunosti u skladu sa članom 2. „Oblast delovanja“ Zakona o parlamentarnoj istrazi, a njen istražni rad obuhvatiće i biti ograničen na razjašnjavanje činjenica, utvrđivanje i opisivanje događaja kako bi se razjasnilo šta se dogodilo od odluka, radnji i nečinjenja nosilaca Ministarstva spoljnih poslova u oblasti upravljanja diplomatskim osobljem i pripadnika spoljne službe.

Mi, poslanici podnosioci zahteva, u cilju ostvarivanja svog ustavnog poslaničkog mandata, ističemo veliku potrebu sprovođenja ove istrage, posebno kada se ima u vidu da ovo ministarstvo ima direktnu nadležnost za upravljanje spoljnopolitičkim procesima Republike Kosova.

Iako je do sada u nekim slučajevima Skupština Republike Kosovo raspravljala o spoljnoj politici, ponekad nije preuzela odgovornost za postavljanje i sprovođenje parlamentarne istrage koja bi razjasnila stepen pravne odgovornosti nosilaca ovog ministarstva za stanje u njemu koje je donelo ovo ministarstvo.

Ovakva parlamentarna istražna komisija, pored ispunjavanja parlamentarne ustavne obaveze koju poslanici Skupštine Republike Kosovo imaju da nadgledaju, između ostalog, i vladu, takođe bi pomogla da se razjasni pravna i upravljačka odgovornost ovog ministarstva i garantovala bi institucionalnu transparentnost rasvetljavanjem istina koje nisu poznate građanima Kosova u vezi sa nekim od ključnih pitanja kao što su:

- Po kom pravnom osnovu i po kojim kriterijumima je došlo do spajanja Ministarstva za dijasporu sa Ministarstvom spoljnih poslova?
- Po kom pravnom osnovu se sklapaju ugovori o angažovanju spoljnih savetnika ?
- Po kom pravnom osnovu su isključene diplomate primljene po konkursu od 2011. godine?
- Po kom pravnom osnovu se diplomate prebacuju iz jedne misije u drugu?
- Da li su ispunjeni kriterijumi za premeštaj javnih funkcionera na rukovodeća mesta u Ministarstvu unutrašnjih poslova i veza?
- Kako su vršena premeštanja funkcionera u okviru Ministarstva spoljnih poslova?
- Da li je Komisija za diplome i discipline poštovala zakonske rokove?
- Da li su primenjeni zakonski kriterijumi prilikom donošenja rešenja o napredovanju i u procesu rotacije?
- Da li su službenici bez iskustva slati u spoljne službe?
- Na osnovu čega su vršena politička imenovanja?
- U koliko slučajeva i da li su sprovedene zakonske procedure za popunjavanje mesta sa v.d. zamenika?
- Da li su ispoštovani kriterijumi za prijem na rad u ovo ministarstvo?
- Da li je bilo primene dvostrukih standarda u slučaju isplate plata funkcionera van zemlje ?
- Da li je bilo slučajeva zapošljavanja lica na osnovu ugovora o radu i ako jeste, pod kojim uslovima i kriterijumima?
- Da li je primenjen zakonski kriterijum za penzionisanje funkcionera koji su navršili 65 godina života?
- Da li je došlo do kršenja prava iz radnog odnosa službenika Ministarstva spoljnih poslova?

Ova i mnoga druga pitanja će, bez predrasuda, staviti pred sobom Parlamentarna istražna komisija i ja ću morati da odgovorim kroz konačan i stručan izveštaj, i zasnovan na činjenicama i dokazima, koji ću podneti Skupštini na usvajanje.

Iz gore iznetog, kao i radi utvrđivanja odgovornosti odgovornih službenih lica u vezi sa navedenim aspektima, Komisija će u svom istražnom radu uključiti, ali se neće ograničiti na saradnju sa bilo kojim privatnim ili javnim licem, institucijom ili organizacijom, koji će, prema njihovoj oceni, pomoći da se obezbede relevantni podaci, dokazi ili pojašnjenja koji odgovaraju svrsi zbog koje je Komisija osnovana i da donese određeni zaključak u skladu sa važećim zakonodavstvom.

Mi, poslanici koji podnose ovaj zahtev, predlažemo da Skupštinska anketna komisija u svom sastavu ima jedanaest (11) članova, i u skladu sa zakonom na snazi, da mandat ove komisije traje šest (6) meseci od osnivanja od strane Skupštine.

Na kraju, mi poslanici koji podnosimo ovaj zahtev ističemo da pozdravljamo razmatranje u Skupštini delokruga rada ove Komisije i spremni smo da dodamo predmete pitanja koja se odnose na opšti proces upravljanja Ministarstvom inostranih poslova, i naravno, samo uz našu saglasnost kao predlagača, da finaliziramo spisak pitanja kojima će se baviti predložena anketna komisija.

Hvala Vam!

S poštovanjem,  
**Ariana Musliu – Shoshi**

---

**Poslanica**

**Spisak poslanika – potpisnika zahteva za:**

**- Parlamentarnu istragu o nivou upravljanja radnim odnosom pripadnika Službe spoljnih poslova i službenika Ministarstva spoljnih poslova i dijaspore;**

1. \_\_\_\_\_  
(Ime i prezime) (Potpis)

2. \_\_\_\_\_  
(Ime i prezime) (Potpis)

3. \_\_\_\_\_  
(Ime i prezime) (Potpis)

4. \_\_\_\_\_  
(Ime i prezime) (Potpis)

5. \_\_\_\_\_  
(Ime i prezime) (Potpis)

6. \_\_\_\_\_  
(Ime i prezime) (Potpis)

7. \_\_\_\_\_  
(Ime i prezime) (Potpis)

8. \_\_\_\_\_  
(Ime i prezime) (Potpis)